

# OPINIONI I QYTETARËVE PËR POLICINË

**Rezultatet e një sondazhi të opinionit publik  
të kryer në Maqedoni**

**Shtator, 2017**



## **OPINIONI I QYTETARËVE PËR POLICINË**

Results of the Public Opinion Survey  
Conducted in Macedonia

### **BOTUES**

Analytica  
Albert Švajcer 6, Shkup, Maqedoni  
Tel: +389 23 151 948  
E-mail: [info@analyticamk.org](mailto:info@analyticamk.org)  
[www.analyticamk.org](http://www.analyticamk.org)  
[www.pointpulse.net](http://www.pointpulse.net)

### **AUTOR**

Magdalena Lembovska

### **REDAKTOR**

Saša Djordjević

### **PËRKTHYER NË SHQIP NGA**

Durim Tabaku

### **GRAFIKA DHE FAQOSJA**

DTP

Shkup, 2017

# TABELA E PËRMBAJTJES

|  |           |
|--|-----------|
| <b>LISTA E GRAFIKËVE DHE TABELAVE.....</b>   | <b>4</b>  |
| <b>PËR SONDAZHIN .....</b>   | <b>6</b>  |
| <b>PËRMBLEDHJE .....</b>   | <b>7</b>  |
| <b>BESIMI NË INSTITUCIONE.....</b>   | <b>8</b>  |
| Policia nuk është më e para në besimin e publikut.....   | 8         |
| Nivele të ulëta të besimit tek gjykatat .....  | 12        |
| <b>PERCEPTIMI PËR POLICINË.....</b>  | <b>14</b> |
| Qëndrim pozitiv ndaj oficerëve dhe oficerëve të policisë .....   | 14        |
| Oficerët e policisë punësohen nëpërmjet lidhjeve politike dhe mbrojnë interesat e partive politike ..... | 15        |
| Ndikim i madh i politikanëve në punën operative të policisë .....  | 18        |
| <b>PERCEPTIMI PËR KORRUPSIONIN .....</b>   | <b>20</b> |
| Gjykatat janë institucioni më i korruptuar.....  | 20        |
| Policia rrugore dhe bashkëpunëtorët e afërt të Ministrisë janë pjesa më e korruptuar e policisë.....     | 24        |
| <b>LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT .....</b>   | <b>26</b> |
| Qytetarët maqedonas janë të gatshëm të denoncojnë korrupsionin në radhët e policisë.....                 | 26        |
| Stacioni lokal i policisë është zgjedhja e parë për denoncimin e korrupsionit të policisë.....           | 28        |
| Motivimi i qytetarëve për të raportuar korrupsionin e policisë është masa më e domosdoshme.....          | 29        |
| OJQ-të duhet të bashkëpunojnë me shtetin në luftën kundër korrupsionit .....                             | 31        |
| <b>KUADRI METODOLOGJIK .....</b>   | <b>33</b> |

# LISTA E GRAFIKËVE DHE TABELAVE

- Grafiku 1: Besimi tek policia në Maqedoni
- Grafiku 2: Dallimet sipas gjinisë në perceptimin për policinë
- Grafiku 3: Dallimet sipas moshës në perceptimin për policinë
- Grafiku 4: Dallimet sipas etnisë në perceptimin për policinë
- Grafiku 5: Dallimet sipas nivelit arsimor në perceptimin për policinë
- Grafiku 6: Dallimet sipas punësimit në perceptimin për policinë
- Grafiku 7: Dallimet sipas vendbanimit në perceptimin për policinë
- Grafiku 8: Dallimet sipas zonës urbane/rurale në perceptimin për policinë
- Grafiku 9: Lista e renditjes së institucioneve në Maqedoni sipas besimit të publikut
- Grafiku 10: Përshkrimi i një oficerije të policisë (përgjigja e parë)
- Grafiku 11: Përshkrimi i një oficeri policie (përgjigja e parë)
- Grafiku 12: Përzgjedhja e kandidatëve dhe punësimi në polici (shumë përgjigje)
- Grafiku 13: Në interes të kujt vepron më së shumti policia?
- Grafiku 14: Në interes të kujt vepron më së paku policia
- Grafiku 15: Dallimet sipas moshës – Në interes të kujt vepron më së shumti policia
- Grafiku 16: Dallimet sipas punësimit - Në interes të kujt vepron më së shumti policia
- Grafiku 17: Dallimet sipas etnisë - Në interes të kujt vepron më së shumti policia
- Grafiku 18: Ndikimi i politikës në punën operative të policisë
- Grafiku 19: Dallimet sipas etnisë në perceptimin për ndikimin e politikës në punën operative të policisë
- Grafiku 20: Perceptimi për korrupsionin në institucionet në Maqedoni (3+4)
- Grafiku 21: Perceptimi për korrupsionin në institucionet në Maqedoni (1+2)
- Grafiku 22: Dallimet sipas gjinisë në perceptimin për korrupsionin në polici
- Grafiku 23: Dallimet sipas etnisë në perceptimin për korrupsionin në polici
- Grafiku 24: Dallimet sipas moshës në perceptimin për korrupsionin në polici
- Grafiku 25: Dallimet sipas vendbanimit në perceptimin për korrupsionin në polici
- Grafiku 26: Perceptimi për korrupsionin në njësitë e ndryshme të policisë (3+4)
- Grafiku 27: Denoncimi i korrupsionit të policisë në Maqedoni
- Grafiku 28: Denoncimi i korrupsionit të policisë në mënyrë anonime në Maqedoni

Grafiku 29: Dallimet sipas etnisë në perceptimin për denoncimin e korrupsionit të policisë

Grafiku 30: Dallimet sipas gjinisë në perceptimin për denoncimin e korrupsionit të policisë

Grafiku 31: Alternativat për denoncimin e korrupsionit të policisë (përgjigja e parë)

Grafiku 32: Alternativat për denoncimin e korrupsionit të policisë (shumë përgjigje)

Grafiku 33: Masat më të domosdoshme për parandalimin e korrupsionit në polici

Grafiku 34: Dallimet sipas etnisë për masat më të domosdoshme për parandalimin e korrupsionit në polici

Grafiku 35: Institucionet që duhet të drejtojnë luftën kundër korrupsionit

Grafiku 36: Roli i OJQ-ve në luftën kundër korrupsionit

Grafiku 37: Dallimet sipas etnisë për rolin e OJQ-ve në luftën kundër korrupsionit

Tabela 1: Niveli i besimit tek institucionet e Maqedonisë

Tabela 2: Përhapja e korrupsionit në institucionet në Maqedoni

Tabela 3: Perceptimi për korrupsionin në njësitë e ndryshme të policisë

# PËR SONDAZHIN

Raundi i tretë i sondazhit të opinionit publik “Opinionit i qytetarëve për forcat e policisë” u zhvillua në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni dhe Serbi. Pyetësi në bazë të të cilit u krye sondazhi i opinionit publik u hartua nga rrjeti rajonal POINTPULSE për t’iu dhënë përgjigje në lidhje me mendimin e qytetarëve për policinë. Pyetësi kishte gjashtë grupe pyetjesh:

1. Niveli i besimit të qytetarëve tek institucionet;
2. Perceptimi për policinë si institucion, por edhe për oficerët dhe oficeret e policisë si individë;
3. Perceptimi për korrupsionin në shoqëri dhe në forcat e policisë;
4. Opinioni i qytetarëve për luftën kundër korrupsionit;
5. Opinioni i qytetarëve për punën e organizatave të shoqërisë civile;
6. Të dhëna demografike.

Kërkimi në terren në Maqedoni u krye në korrik të vitit 2017 nga IPSOS Strategic Marketing, me një kampion përfaqësimi prej 1,000 personash madhorë, qytetarë të Maqedonisë. Si instrument kërkimi u përdor një pyetësor dhe intervistat u kryen duke përdorur teknikën “intervistë telefonike e asistuar me kompjuter” (CATI).

Raporti u botua si pjesë e projektit “Pulsi i Ballkanit Perëndimor për Integritetin dhe Besimin në Polici”, projekt që synon të kontribuojë në rritjen e besimit tek policia duke promovuar përgjegjshmërinë dhe duke forcuar integritetin e saj. Për këtë arsye, shtatë organizatat e shoqërisë civile nga rajoni u bënë bashkë për të krijuar rrjetin POINTPULSE: Analytica nga Shkupi, Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (BIRN) nga Beogradi, Qendra për Studime të Sigurisë (CSS) nga Sarajeva, Instituti Alternativa (IA) nga Podgorica, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) nga Tirana, dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) nga Prishtina.

Projekti mbështetet nga Bashkimi Evropian përmes programit “Instrumenti i Shoqërisë Civile” në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e Analytica-s dhe pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian.

# PËRMBLEDHJE

Policia është institucioni i dytë më i besuar në Maqedoni mes institucioneve të përzgjedhura për këtë sondazh të opinionit publik dhe paraprihet vetëm nga sistemi arsimor. Më shumë se gjysma e popullatës së intervistuar (55%) shprehin besimin tek policia, ndonëse gati një e katërta (23%) ende nuk i besojnë aspak policisë. Sondazhi tregoi se punonjësit e policisë gëzojnë një perceptim pozitiv në popull, veçanërisht kur flitet për oficeret femra të policisë. Kjo duhet të merret parasysh nga Ministria e Brendshme gjatë hartimit të strategjisë së komunikimit për rritjen e besimit të publikut. Po ashtu, Ministria duhet të punojë më shumë për të fituar besimin e njerëzve të papunë, studentëve dhe të rinjve në përgjithësi, pasi niveli i besimit tek këto kategori ishte më i ulëti.

Punonjësit e sektorit privat shprehin besimin më të madh në polici, të ndjekur nga ata që punojnë në sektorin publik dhe nga pensionistët. Niveli i besimit tek policia mes shqiptarëve etnikë është rritur në vitin 2017, gjë që përbën një tendencë pozitive duke qenë se ky nivel besimi ka qenë shumë më i ulët se ai i maqedonasve etnikë. Aktualisht, nuk ka dallime të rëndësishme mes këtyre dy grupeve etnike.

Sondazhi tregoi se qytetarët besojnë se politika luan një rol të rëndësishëm në punën e policisë - duke filluar që me praktikat e punësimit, të cilat konsiderohen si të varura nga lidhjet politike të kandidatit, por edhe në punën operative të policisë. Qytetarët e shohin policinë kryesisht si një mjet për mbrojtjen e interesave të partive politike apo grupeve të tjera të caktuara. Në përputhje me këtë konstatim, shumica e qytetarëve mendojnë se politikanët ushtrojnë një nivel të lartë ndikimi në punën operative të policisë. Prandaj, Ministria e Brendshme duhet të bëjë një përpjekje të konsiderueshme për depolitizimin e policisë dhe të sigurojë zbatimin e standardeve profesionale në të gjitha nivelet brenda këtij institucioni.

Edhe pse besimi i publikut në polici është relativisht i lartë, ekziston edhe perceptimi i përhapjes së korrupsionit, gjë që tregon një tolerancë të lartë të korrupsionit në shoqërinë maqedonase. Sidoqoftë, është inkurajuese të shihet se shumica (70%) e qytetarëve janë të gatshëm të denoncojnë korrupsionin e policisë edhe nëse u kërkohej të japin të dhënat e tyre personale. Për më tepër, rreth gjysma e tyre do të ndryshonin mendjen dhe do të raportonin një rast korrupsion nëse mund ta bënin këtë raportim në mënyrë anonime. Përveç kësaj, ekziston një konsensus i gjerë që motivimi i qytetarëve për të denoncuar policët e korruptuar është veprimi më i domosdoshëm për parandalimin e korrupsionit. Prandaj, aktorët e këtij procesi duhet të përqendrohen në promovimin e zbatimit të mekanizmave për mbikëqyrjen dhe kontrollin e policisë. Nëse qytetarët besojnë se denoncimet e tyre merren seriozisht dhe se oficerët e korruptuar të policisë do të mbajnë përgjegjësi për veprat e tyre, vetë qytetarët do të inkurajohen më shumë për të raportuar raste të tjera të korrupsionit.

Stacioni lokal i policisë është zgjedhja e parë për raportimin e korrupsionit të policisë, ndërsa njësia e kontrollit të brendshëm - e cila aktualisht është përgjegjëse për raste të tilla - nuk është një zgjedhje shumë popullore. Megjithatë, pjesa më e madhe e të intervistuarve mendojnë se shërbimi i kontrollit të brendshëm në radhët e policisë duhet të jetë i pari për luftën kundër korrupsionit në polici. Është po aq interesante të theksohet se një e katërta e qytetarëve do të raportonin një rast korrupsioni tek një shok/shoqe që punon në polici, që do të thotë se qytetarët shpesh preferojnë më shumë kanalet informale dhe më tepër i drejtohen njerëzve si individë sesa vetë institucioneve. Prandaj, të gjithë punonjësit brenda Ministrisë duhet të trajnohen për të trajtuar situata të tilla. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që personeli që punon në stacionet lokale të policisë të trajnohet siç duhet në marrjen dhe procedimin e denoncimeve për korrupsionin në polici.

# BESIMI NË INSTITUCIONE


Besimi tek institucionet publike është i rëndësishëm për suksesin e një sërë politikash publike. Duke qenë se policia është një nga institucionet më të rëndësishme përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, e cila ka edhe “monopolin e dhunës”, besimi i publikut në këtë institucion është i një rëndësie të veçantë.

## Policia nuk është më e para në besimin e publikut

Sondazhi tregoi se policia nuk është më institucioni më i besuar në Maqedoni; tani ajo renditet e dyta, pas sistemit arsimor. Ky është rezultat i rënies së lehtë të nivelit të besimit të publikut tek policia dhe i rritjes së nivelit të besimit të publikut tek sistemi arsimor. Më konkretisht, arsimi tani besohet nga 62% e të intervistuarve (52% në vitin 2016). Nga ana tjetër, 55% e të anketuarve thanë se ata i besojnë kryesisht ose plotësisht policisë (58% në vitin 2016).

### Grafiku 1: Besimi tek policia në Maqedoni

Pyetja: Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme në Maqedoni? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk i besoj aspak institucionit, 2 kryesisht nuk i besoj institucionit, 3 kryesisht i besoj institucionit, 4 i besoj plotësisht institucionit.




Nuk ka dallime të konsiderueshme mes gjinive në lidhje me nivelin e besimit në polici. Për sa i përket grupmoshave, të intervistuarit e moshës 30-44 vjeç janë më shumë të prirur të kenë besim tek policia (61% i besojnë kryesisht ose plotësisht asaj dhe 39% nuk i besojnë aspak), pasuar nga të intervistuarit e moshës 45-59 vjeç. Niveli i besimit është më i ulët tek të rinjtë dhe të anketuarit e moshuar - vetëm gjysma e tyre kanë shprehur besimin e tyre në këtë institucion: 49% e të anketuarve të moshës mbi 60 vjeç dhe 51% e atyre të grupmoshës 18-29 vjeç.




## Grafiku 2: Dallimet sipas gjinisë në perceptimin për policinë

Pyetja: Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme në Maqedoni? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk i besoj aspak institucionit, 2 kryesisht nuk i besoj institucionit, 3 kryesisht i besoj institucionit, 4 i besoj plotësisht institucionit.



## Grafiku 3: Dallimet sipas moshës në perceptimin për policinë


Pyetja: Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme në Maqedoni? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk i besoj aspak institucionit, 2 kryesisht nuk i besoj institucionit, 3 kryesisht i besoj institucionit, 4 i besoj plotësisht institucionit.



Ndryshe nga rezultatet e vitit të kaluar, kur niveli i besimit ishte shumë më i lartë mes maqedonasve etnikë sesa mes shqiptarëve etnikë, tani nuk ka dallime të rëndësishme mes këtyre grupeve etnike. Ky është rezultat i rritjes së nivelit të besimit tek policia nga shqiptarët etnikë dhe i rënies së nivelit të besimit mes maqedonasve etnikë. Në vitin 2016, 63% e maqedonasve etnikë dhe 41% e shqiptarëve etnikë u përgjigjën pozitivisht, ndërsa 37% e maqedonasve etnikë dhe 59% e shqiptarëve etnikë reagojnë negativisht. Këtë vit, nga sondazhi tregohet një pamje krejtësisht e ndryshme. Shifrat janë pothuajse të barabarta: 54% e maqedonasve etnikë dhe 54% e shqiptarëve etnikë thonë se i besojnë policisë, ndërsa 44% e maqedonasve etnikë dhe 46% e shqiptarëve etnikë shprehen se nuk kanë besim tek policia.

#### Grafiku 4: Dallimet sipas etnisë në perceptimin për policinë


Pyetja: Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme në Maqedoni? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk i besoj aspak institucionit, 2 kryesisht nuk i besoj institucionit, 3 kryesisht i besoj institucionit, 4 i besoj plotësisht institucionit.



Njerëzit me nivel më të ulët arsimor i besojnë policisë më shumë: 60% e atyre me arsim fillor të papërfunduar janë përgjigjur pozitivisht, ashtu si edhe 51% e atyre që kanë përfunduar arsimin fillor. Kur të dhënat shihen nga këndvështrimi i profesionit, studentët me sa duket shprehin nivelin më të ulët të besimit dhe më shumë se gjysma e tyre përgjigjen se nuk i besojnë policisë (56% nuk i besojnë dhe 44% i besojnë policisë). Ata pasohen nga të papunët që aktualisht janë të ndarë (50% nuk i besojnë dhe 50% besojnë). Është e rëndësishme të theksohet se gati një e treta e personave aktualisht të papunë thanë se nuk i besojnë aspak policisë. Nga ana tjetër, niveli i besimit është më i larti tek të intervistuarit e punësuar në sektorin privat (60% i besojnë policisë dhe 39% nuk i besojnë asaj), më pas vijnë të punësuar në sektorin publik (55% i besojnë dhe 45% nuk i besojnë), ndërsa pensionistët ndodhen diku në mes (53% besojnë dhe 41% nuk i besojnë policisë).


#### Grafiku 5: Dallimet sipas nivelit arsimor në perceptimin për policinë

Pyetja: Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme në Maqedoni? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk i besoj aspak institucionit, 2 kryesisht nuk i besoj institucionit, 3 kryesisht i besoj institucionit, 4 i besoj plotësisht institucionit.



### Grafiku 6: Dallimet sipas punësimit në perceptimin për policinë


Pyetja: Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme në Maqedoni? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk i besoj aspak institucionit, 2 kryesisht nuk i besoj institucionit, 3 kryesisht i besoj institucionit, 4 i besoj plotësisht institucionit.



Qytetarët nga pjesa jugperëndimore e Maqedonisë kanë mendimet më pozitive për policinë, ku 57% deklarojnë se i besojnë këtij institucioni. Ata ndiqen nga qytetarët e Maqedonisë veri-perëndimore (përfshirë Kumanovën). Të anketuarit nga Shkupi dhe ata nga Maqedonia lindore dhe qendrore kanë më shumë pikëpamje të ngjashme, me rreth 52-53% të të anketuarve që shprehin besimin tek policia. Përveç kësaj, ata që jetojnë në zonat urbane kanë besim pak më të madh se ata që banojnë në zonat rurale. Megjithatë, dallimi është shumë i vogël: 55% e atyre në zonat urbane dhe 53% në zonat rurale kanë shprehur besimin e tyre tek policia.


### Grafiku 7: Dallimet sipas vendbanimit në perceptimin për policinë

Pyetja: Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme në Maqedoni? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk i besoj aspak institucionit, 2 kryesisht nuk i besoj institucionit, 3 kryesisht i besoj institucionit, 4 i besoj plotësisht institucionit.



## Grafiku 8: Dallimet sipas zonës urbane/rurale në perceptimin për policinë

Pyetja: Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme në Maqedoni? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk i besoj aspak institucionit, 2 kryesisht nuk i besoj institucionit, 3 kryesisht i besoj institucionit, 4 i besoj plotësisht institucionit.



## Nivele të ulëta të besimit tek gjykatat

Përveç sistemit arsimor dhe policisë, të cilat u analizuan më lart, i vetmi sektor tjetër që ka fituar besimin e më shumë se 50% të popullsisë është kujdesi shëndetësor, i cili besohet kryesisht ose plotësisht nga 50% e popullsisë. Të gjitha institucionet e tjera kanë dalë me më pak se 50% në besimin e publikut.

### Tabela 1: Niveli i besimit tek institucionet e Maqedonisë

Pyetja: Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme në Maqedoni? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk i besoj aspak institucionit, 2 kryesisht nuk i besoj institucionit, 3 kryesisht i besoj institucionit, 4 i besoj plotësisht institucionit.

|                              | nuk i besoj aspak | kryesisht nuk i besoj | kryesisht i besoj | i besoj plotësisht | Nuk e di | Shumatore - | Shumatore + |
|------------------------------|-------------------|-----------------------|-------------------|--------------------|----------|-------------|-------------|
| <b>Doganat</b>               | 24.8              | 24.7                  | 31.6              | 14.5               | 04.5     | 49.5        | 46.0        |
| <b>Arsimi</b>                | 16.3              | 19.9                  | 34.8              | 27.3               | 01.7     | 36.2        | 62.1        |
| <b>Shëndetësia</b>           | 24.5              | 25.1                  | 33.3              | 17.0               | 00.1     | 49.6        | 50.3        |
| <b>Gjykatat</b>              | 45.8              | 22.0                  | 20.3              | 10.1               | 01.7     | 67.8        | 30.4        |
| <b>Inspektorati i tregut</b> | 32.5              | 25.0                  | 27.4              | 10.8               | 04.4     | 57.5        | 38.2        |
| <b>Policia</b>               | 23.3              | 20.7                  | 34.6              | 19.9               | 01.5     | 44.0        | 54.5        |
| <b>Bashkia</b>               | 27.0              | 23.4                  | 33.1              | 14.9               | 01.5     | 50.5        | 48.0        |
| <b>Parlamente</b>            | 39.5              | 21.9                  | 23.8              | 12.6               | 02.2     | 61.4        | 36.4        |
| <b>Media</b>                 | 27.3              | 23.6                  | 35.3              | 12.0               | 01.8     | 50.9        | 47.3        |
| <b>OJQ-të</b>                | 30.4              | 17.7                  | 31.5              | 15.7               | 04.7     | 48.1        | 47.2        |


|                                     |      |      |      |      |      |      |      |
|-------------------------------------|------|------|------|------|------|------|------|
| <b>Agjencia Kundër Korruptionit</b> | 47.1 | 22.6 | 18.3 | 09.9 | 02.1 | 69.8 | 28.1 |
| <b>Prokuroria</b>                   | 44.0 | 20.2 | 21.6 | 11.9 | 02.3 | 64.2 | 33.5 |

Institucioni më pak i besuar është Agjencia Kundër Korrupsionit, për të cilën pothuajse 70% e qytetarëve kanë dhënë një opinion negativ (23% nuk i besojnë kryesisht dhe plot 47% që nuk i besojnë aspak). Vetëm 10% e të anketuarve i besojnë plotësisht këtij institucioni, ndërkohë që 19% kryesisht besojnë tek ky institucion. Është për t'u shqetësuar fakti që edhe gjykatat dhe prokuroria janë ndër institucionet më pak të besuara nga publiku: 68% kanë perceptim negativ dhe vetëm 30% e të intervistuarve kanë mendim pozitiv për gjyqësorin, ndërsa për prokurorinë kjo ndarje është 64% kanë perceptim negativ dhe 34% pozitiv. Këto rezultate tregojnë se qytetarët nuk tregojnë shumë besim në sistemin e drejtësisë penale apo mekanizmat e pavarur të kontrollit. Meqenëse këto institucione janë ato që duhet të udhëheqin luftën kundër korrupsionit, niveli i ulët i besimit tregon se ato nuk kanë arritur ta tregojnë veten si të tillë.

Një tjetër institucion që ka dalë me rezultate të këqija është Parlamenti, ku 61% e popullsisë shprehin mosbesim dhe vetëm 36% janë përgjigjur se i besojnë kryesisht ose plotësisht këtij institucioni. Këto rezultate pritej të ishin të tilla, duke pasur parasysh kontekstin politik në Maqedoni. Parlamenti maqedonas nuk u formua për disa muaj pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të muajit dhjetor 2016. Po ashtu, konstituimi i Parlamentit u bë në një atmosferë shumë të tensionuar, përfshirë këtu një sulm fizik ndaj deputetëve nga një turmë njerëzish të dalë jashtë kontrollit si dhe sjelljen problematike të policisë dhe të disa aktorëve të tjerë.

### Grafiku 9: Lista e renditjes së institucioneve në Maqedoni sipas besimit të publikut

Pyetja: Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme në Maqedoni? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk i besoj aspak institucionit, 2 kryesisht nuk i besoj institucionit, 3 kryesisht i besoj institucionit, 4 i besoj plotësisht institucionit.



# PERCEPTIMI PËR POLICINË


## Qëndrim pozitiv ndaj oficerëve dhe oficerëve të policisë

Qytetarët normalisht përdorin mbiemra pozitivë për të përshkruar policet femra. Të parat mbiemra që u vijnë në mendje janë: “të mira” (12%), “si të gjithë të tjerët” ose “bëjnë punën e tyre” (7%), “korrekte” (6%), “me mirësi/kulturë/mirësjellje” (6%), “me ndërgjegje” (5%), “ka guxim” (4%), dhe së fundi “miqësore/e dobishme/komunikuese”, dhe “punon duke respektuar ligjin”(3%). Disa qytetarë i përshkruajnë ato në aspektin e bukurisë, apo pamjes tërheqëse dhe sharmit (3%). Nëse bëjmë llogaritjet duke u bazuar në shumë përgjigje, do të shohim se mbizotërojnë ende mbiemra pozitivë.

I vetmi perceptim negativ që lidhet me oficeren e policisë është “e papërgatitur - fizikisht, me pajisje të këqija” (4%), ndërsa mbiemra të tjerë negativë (si arrogante, jo korrekte, e paedukatë, etj.) përmenden fare rrallë.

### Grafiku 10: Përshkrimi i një oficerëve të policisë (përgjigja e parë)


Pyetja: Kur mendoni për policen femër, e cila është në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët, si do ta përshkruanit atë? Ju lutemi të theksoni disa karakteristika, të cilat sipas mendimit tuaj do ta përshkruanin më së miri policen mesatare femër në Maqedoni.



Kur nuk përcaktohej gjinia e oficerëve të policisë, fjala e parë për të përshkruar një oficer/e ishte “të mira” (12%), “si të gjithë të tjerët” ose “bëjnë punën e tyre” (7%), “me mirësi/kulturë/mirësjellje” (7%). Megjithatë, qytetarët përdorin edhe mbiemra negativë, si “të paedukatë”, “me mungesë kulture dhe sjellje e pahijshme” (6%) dhe “të korruptuar” (3%). Nëse analizojmë përgjigjet duke u bazuar në shumë përgjigje, do të shohim se mbizotërojnë ende mbiemra pozitivë.

### Grafiku 11: Përshkrimi i një oficeri policie (përgjigja e parë)

Pyetja: Kur mendoni për policin mesatar mashkull, i cili është në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët, si do ta përshkruanit atë? Ju lutemi të theksoni disa karakteristika, të cilat sipas mendimit tuaj do ta përshkruanin më së miri policin tipik në Maqedoni.




### Oficerët e policisë punësohen nëpërmjet lidhjeve politike dhe mbrojnë interesat e partive politike

Pothuajse gjysma e popullsisë (44%) besojnë se punonjësit e policisë përzgjidhen dhe punësohen nëpërmjet lidhjeve të tyre politike, ndërsa 18% e qytetarëve mendojnë se kjo bëhet me anë të lidhjeve shoqërore dhe familjare. Vetëm 13% e të anketuarve besojnë se punësimi fitohet përmes konkursit publik. Një numër i vogël qytetarësh (4%) mendojnë se kjo arrihet duke i dhënë rryshfet një personi me ndikim. Një e treta e të anketuarve thanë diçka tjetër ose refuzuan të përgjigjen.

### Grafiku 12: Përzgjedhja e kandidatëve dhe punësimi në polici (shumë përgjigje)


Pyetja: Sipas mendimit tuaj, në çfarë mënyre bëhet përzgjedhja e kandidateve për punësim në radhët e policisë?



Qytetarët shprehen se forcat e policisë veprojnë si mjet për mbrojtjen e interesave të grupeve të ndryshme: 36% e tyre besojnë se policia shërben për të mbrojtur interesat e partive politike, 22% për mbrojtjen e interesave të qeverisë dhe 15% mendojnë se policia vepron si mjet për mbrojtjen e interesave të drejtuesve në nivelet më të larta të policisë. Vetëm pak më shumë se një e katërta (27%) e të anketuarve janë të mendimit se policia vepron në shërbim të qytetarëve.

### Grafiku 13: Në interes të kujt vepron më së shumti policia?


Pyetja: Në cilin kapacitet vepron më së shumti policia në vendin tuaj?



Kur të intervistuarve iu bë pyetja e kundërt: “Në cilin kapacitet vepron më së paku policia në vendin tuaj”, 62% e tyre u përgjigjën se ajo shërben më së paku si shërbim ndaj qytetarëve, 15% që vepron më së paku si një mjet për mbrojtjen e interesave të partive politike, 11% që mbron interesat e qeverisë, dhe 11% u përgjigjën se policia vepron më së paku si një mjet për mbrojtjen e interesave të drejtuesve të të lartë të policisë.

### Grafiku 14: Në interes të kujt vepron më së paku policia

Pyetja: Në cilin kapacitet vepron më së paku policia në vendin tuaj?




Të anketuarit të moshës mbi 60 vjeç ishin më të predispozuar të besonin se policia vepron si një shërbim ndaj qytetarëve (28% kanë dhënë këtë përgjigje), ndërsa ata të moshës 15 deri në 59 vjeç ishin më të prirur të mendonin se policia shërben si mjet për mbrojtja e interesave të partive politike (41%).



Sipas analizës së gjendjes së punësimit, ata që punojnë në sektorin publik priren të besojnë se policia vepron si një shërbim ndaj qytetarëve, ndërsa të papunët e tanishëm besojnë kryesisht se policia i shërben interesave të partive politike (41% kanë dhënë pikërisht këtë përgjigje).


### Grafiku 15: Dallimet sipas moshës – Në interes të kujt vepron më së shumti policia

Pyetja: Në cilin kapacitet vepron më së shumti policia në vendin tuaj?



### Grafiku 16: Dallimet sipas punësimit - Në interes të kujt vepron më së shumti policia


Pyetja: Në cilin kapacitet vepron më së shumti policia në vendin tuaj?



Dallimet më të rëndësishme mund të vërehen mes grupeve etnike. Shqiptarët etnikë janë më pak të prirur ta konsiderojnë policinë si shërbim të qytetarëve (vetëm 17%), dhe perceptimi i tyre është shumë më i ulët se ai i maqedonasve etnikë, ku 29% e qytetarëve kanë këtë mendim. Nga ana tjetër, pothuajse gjysma (48%) e popullsisë shqiptare e sheh policinë si një mjet për mbrojtjen e interesave të partive politike. Përqindja e maqedonasve etnikë që dhanë këtë përgjigje ishte 34%.

## Grafiku 17: Dallimet sipas etnisë - Në interes të kujt vepron më së shumti policia

Pyetja: Në cilin kapacitet vepron më së shumti policia në vendin tuaj?




## Ndikim i madh i politikanëve në punën operative të policisë

Ekziston një perceptim i përgjithshëm i ndikimit tepër të madh të politikanëve në punën operative të policisë: 61% e të intervistuarve janë të këtij mendimi. Nga ky numër, 37% mendojnë se ndikimi i politikanëve është shumë i lartë dhe 25% e tyre mendojnë se politikanët ndikojnë plotësisht në punën e policisë. Po ashtu, ka pasur një rritje në krahasim me vitin e kaluar (55% janë përgjigjur duke përdorur termat 'krejtësisht' ose 'në një shkallë të konsiderueshme'). Vetëm 12% e të anketuarve (në krahasim me 16% në vitin 2016) mendojnë se politikanët nuk ndikojnë aspak në punën operative të policisë.

## Grafiku 18: Ndikimi i politikës në punën operative të policisë


Pyetja: Sipas mendimit tuaj, në çfarë mase politikanët kanë ndikim në punën operative të Policisë?



Është interesante të vërehet se maqedonasit etnikë perceptojnë një nivel më të lartë të ndikimit të politikanëve sesa shqiptarët etnikë: 41% e maqedonasve etnikë dhe 25% e shqiptarëve etnikë thanë se ndikimi i politikanëve është i pranishëm në një shkallë të konsiderueshme, ndërsa 26% e maqedonasve etnikë dhe 23% e shqiptarëve etnikë mendonin se politikanët ndikojnë plotësisht në punën operative të policisë. Nga ana tjetër, 20% e shqiptarëve etnikë dhe vetëm 9% e maqedonasve etnikë thanë se politikanët nuk kishin aspak ndikim në punën operative të policisë.

### Grafiku 19: Dallimet sipas etnisë në perceptimin për ndikimin e politikës në punën operative të policisë

Pyetja: Sipas mendimit tuaj, në çfarë mase politikanët kanë ndikim në punën operative të Policisë?



# PERCEPTIMI PËR KORRUPSIONIN

## Gjykatat janë institucioni më i korruptuar

Të anketuarve iu dha një listë institucionesh dhe u pyetën rreth mendimit të tyre se sa i përhapur është korrupsioni në secilën prej këtyre institucioneve. Për fat të keq, qytetarët e perceptojnë korrupsionin si të përhapur në të gjitha institucionet dhe secili prej këtyre institucioneve mori mbi 50% të qytetarëve. Organizatat joqeveritare (OJQ) konsiderohen si më pak të korruptuara: 50% e qytetarëve besojnë se korrupsioni në OJQ është disi i përhapur ose i shumë përhapur, ndërsa 40% mendojnë se korrupsioni nuk është aspak i përhapur ose në një masë të vogël (paksa i përhapur).

**Tabela 2: Përhapja e korrupsionit në institucionet në Maqedoni**

Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në institucionet e mëposhtme? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur.

|                                     | nuk është aspak i përhapur | paksa i përhapur | disi i përhapur | Shumë i përhapur | Nuk e di | Shumatore – | Shumatore + |
|-------------------------------------|----------------------------|------------------|-----------------|------------------|----------|-------------|-------------|
| <b>Doganat</b>                      | 09.2                       | 19.8             | 33.8            | 30.3             | 07.0     | 29.0        | 64.0        |
| <b>Arsimi</b>                       | 13.1                       | 28.7             | 35.9            | 18.4             | 03.9     | 41.8        | 54.3        |
| <b>Shëndetësia</b>                  | 11.0                       | 21.3             | 36.9            | 28.9             | 01.9     | 32.3        | 65.8        |
| <b>Gjykatat</b>                     | 07.8                       | 17.2             | 28.8            | 41.4             | 04.8     | 25.0        | 70.2        |
| <b>Inspektorati i tregut</b>        | 08.6                       | 22.4             | 35.1            | 28.2             | 05.6     | 31.0        | 63.4        |
| <b>Policia</b>                      | 08.5                       | 23.7             | 33.3            | 29.3             | 05.2     | 32.2        | 62.6        |
| <b>Bashkia</b>                      | 12.1                       | 23.2             | 33.8            | 25.8             | 05.2     | 35.3        | 59.6        |
| <b>Parlamente</b>                   | 12.6                       | 20.7             | 26.3            | 28.8             | 11.6     | 33.3        | 55.1        |
| <b>Media</b>                        | 10.8                       | 22.5             | 35.4            | 25.7             | 05.6     | 33.3        | 61.1        |
| <b>OJQ-të</b>                       | 15.3                       | 25.0             | 26.0            | 23.7             | 10.0     | 40.3        | 49.7        |
| <b>Agjencia Kundër Korrupsionit</b> | 14.5                       | 21.5             | 28.9            | 26.3             | 08.7     | 36.0        | 55.2        |
| <b>Prokuroria</b>                   | 11.6                       | 17.9             | 29.7            | 35.1             | 05.8     | 29.5        | 64.7        |


Qytetarët maqedonas i perceptojnë gjykatat si institucionin më të korruptuar në Maqedoni. Një shumicë e konsiderueshme prej 70% e të anketuarve thanë se korrupsioni është disi i përhapur ose shumë i përhapur (29% thanë se ishte disi i përhapur dhe 41% se ishte shumë i përhapur). Nga ana tjetër, vetëm 8% e qytetarëve besojnë se korrupsioni brenda gjyqësorit nuk është aspak i përhapur.

Më pas në listë renditej sistemi shëndetësor (66% e të intervistuarve u përgjigjën se korrupsioni është shumë ose disi i përhapur), pasuar nga prokuroria, doganat, inspektoratet e tregut, policia, dhe në fund mediat. Të gjitha këto institucione kanë arritur nivelin mbi 60%. Për sa i përket pjesës tjetër të tyre (arsimi, bashkitë dhe agjencia kundër korrupsionit), ato konsiderohen nga 50-60% e qytetarëve me korrupsion që është shumë ose disi i përhapur.

Është interesante të theksohet se perceptimi i korrupsionit është shumë i lartë edhe kur bëhet fjalë për institucionet që gëzojnë nivele më të larta të besimit tek popullsia. Kjo do të thotë që korrupsioni tolerohet dhe pranohet nga qytetarët. Për më tepër, ekziston një nivel i lartë i korrupsionit të perceptuar tek të gjitha institucionet brenda sistemit të drejtësisë penale. Këto rezultate janë shqetësuese sepse gjyqësori, prokuroria dhe policia duhet të jenë të parët në luftën kundër çdo forme korrupsioni. Kjo përkon edhe me nivelin shumë të ulët të besimit tek gjyqësori dhe prokuroria të evidentuar nga ky sondazh.

### Grafiku 20: Perceptimi për korrupsionin në institucionet në Maqedoni (3+4)


Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në institucionet e mëposhtme? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur.



Sa i përket perceptimit të korrupsionit në polici, të intervistuarit meshkujt janë më shumë të prirur ta shohin këtë institucion si të korruptuar në krahasim me femrat (65% meshkuj dhe 60% femra u përgjigjën se korrupsioni në polici është disi ose shumë i përhapur). Rezultatet janë të ngjashme edhe kur bëjmë ndarjen sipas etnisë - 66% e shqiptarëve etnikë dhe 60% e maqedonasve etnikë janë përgjigjur në të njëjtën mënyrë.

## Grafiku 21: Perceptimi për korrupsionin në institucionet në Maqedoni (1+2)

Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në institucionet e mëposhtme? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur.




Kur të dhënat analizohen sipas grupmoshave, të rinjtë kanë nivelin më të lartë të perceptimit të korrupsionit në polici: 70% e të intervistuarve të moshës 18-29 vjeç mendojnë se korrupsioni në polici është disi ose shumë i përhapur. Nga ana tjetër janë të moshuarit (të moshës mbi 60 vjeç) ata që e shohin policinë si më pak të korruptuar: 53% e tyre thanë se korrupsioni është disi ose shumë i përhapur, ndërsa 35% besojnë se korrupsioni nuk është aspak i përhapur ose paksa i përhapur. Megjithatë, kjo është edhe grupmosha me përqindjen më të lartë të të anketuarve që nuk dinin se si t'i përgjigjeshin kësaj pyetjeje. Qytetarët e moshës 30-44 vjeç dhe 45-59-vjeç kanë dhënë përgjigje të ngjashme dhe niveli i tyre i korrupsionit të perceptuar prej tyre qëndron në rreth 63-64%.

Qytetarët e Shkupit kanë nivelin më të lartë të perceptimit të korrupsionit në polici - 67% janë përgjigjur pozitivisht dhe ndiqen nga qytetarët e Maqedonisë veriperëndimore (përfshirë Kumanovën), ku kjo përqindje ishte 65%. Qytetarët nga zona të tjera të Maqedonisë kanë pikëpamje po aq të ngjashme: 59% e popullsisë në Maqedoninë jugperëndimore, lindore dhe qendrore e shohin korrupsionin në polici si disi ose shumë të përhapur.


### Grafiku 22: Dallimet sipas gjinisë në perceptimin për korrupsionin në polici

Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në institucionet e mëposhtme? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur.




### Grafiku 23: Dallimet sipas etnisë në perceptimin për korrupsionin në polici

Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në institucionet e mëposhtme? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur.




### Grafiku 24: Dallimet sipas moshës në perceptimin për korrupsionin në polici

Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në institucionet e mëposhtme? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur.



### Grafiku 25: Dallimet sipas vendbanimit në perceptimin për korrupsionin në polici

Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në institucionet e mëposhtme? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur.



### Policia rrugore dhe bashkëpunëtorët e afërt të Ministrit janë pjesa më e korruptuar e policisë

Atyre që besonin se korrupsioni në polici është i përhapur iu kërkua të vlerësonin korrupsionin edhe në njësitë e veçanta të policisë. Njësia më i korruptuar është konsideruar policia rrugore (62% e të intervistuarve që mendojnë se korrupsioni në policinë rrugore është i përhapur dhe 35% që nuk është i përhapur), por bashkëpunëtorët më të afërt të Ministrit konsiderohen në të njëjtën pozitë (61% e të intervistuarve që shprehen se korrupsioni është i përhapur dhe 28% që mendojnë të kundërtën). Vetëm 8-9% e qytetarëve besojnë se korrupsioni nuk është aspak i përhapur në këto njësiti policore.

### Tabela 3: Perceptimi për korrupsionin në njësitet e ndryshme të policisë

Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në njësitet e mëposhtme të policisë? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur.

|  | Nuk është aspak i përhapur | Paksa i përhapur | Disi i përhapur | Shumë i përhapur | Nuk e di | Shumatore – | Shumatore + |
|--|----------------------------|------------------|-----------------|------------------|----------|-------------|-------------|
| <b>Policia kufitare</b>                                | 09.9                       | 24.7             | 36.1            | 21.0             | 08.1     | 34.7        | 57.2        |
| <b>Forcat speciale të policisë</b>                     | 21.9                       | 25.2             | 24.5            | 17.3             | 11.2     | 47.1        | 41.8        |
| <b>Administrata (nxjerrja e dokumenteve personale)</b> | 21.6                       | 31.4             | 27.3            | 16.6             | 03.2     | 53.0        | 43.8        |
| <b>Policia rrugore</b>                                 | 08.2                       | 26.6             | 34.5            | 27.2             | 03.4     | 34.9        | 61.7        |




|  |      |      |      |      |      |      |      |
|--|------|------|------|------|------|------|------|
| <b>Policia e rendit publik dhe sigurisë</b>                  | 15.6 | 30.3 | 30.5 | 18.4 | 05.2 | 45.9 | 49.0 |
| <b>Policia kriminale</b>                                     | 12.7 | 23.6 | 29.6 | 20.9 | 13.1 | 36.4 | 50.5 |
| <b>Bashkëpunëtorët më të afërt të Ministrit të Brendshëm</b> | 09.1 | 19.3 | 29.9 | 30.6 | 11.1 | 28.4 | 60.5 |

Më pas vjen policia kufitare, me 57% të qytetarëve që thonë se korrupsioni në këtë segment është mjaft i përhapur dhe 35% që shprehen për të kundërtën. Në anën tjetër, më pak të korruptuar konsiderohen të jenë ata që janë përgjegjës për çështjet administrative (nxjerrja e dokumenteve personale): 53% e të anketuarve thonë se korrupsioni nuk është përhapur dhe 44% besojnë se ai është i përhapur. Gjithashtu, forcat speciale të policisë besohet nga 42% që janë të korruptuara dhe nga 47% e të anketuarve si jo të korruptuara. Afërsisht gjysma e të intervistuarve besojnë se korrupsioni është i përhapur edhe tek policia kriminale dhe tek policia përgjegjëse për rendin publik dhe sigurinë, ku grupi i fundit doli më mirë në këtë renditje për shkak se përqindja e atyre që dhanë përgjigjen e kundër ishte më e lartë.

Megjithatë, për disa nga këto kategori, përqindja e atyre që nuk dinin se si t'i përgjigjeshin pyetjes ishte mjaft e lartë: ky ishte veçanërisht rasti për sa i përket policisë kriminale (13%), forcave speciale të policisë (11%) dhe bashkëpunëtorëve më të afërt të Ministrit të Brendshëm(11%). Në fakt, një gjë e tillë pritej, duke pasur parasysh natyrën e punës së tyre dhe fakti se veprimtaria e këtyre forcave zakonisht nuk i bëhet e ditur publikut.

### Grafiku 26: Perceptimi për korrupsionin në njësitë e ndryshme të policisë (3+4)

Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në njësitë e mëposhtme të policisë? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur.




# LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

## Qytetarët maqedonas janë të gatshëm të denoncojnë korrupsionin në radhët e policisë

Pjesa më e madhe e qytetarëve të Maqedonisë janë të gatshëm të denoncojnë korrupsionin e policisë. Më konkretisht, 71% e qytetarëve do të denonconin një rast të tillë (rast ku u kërkohet ryshfet) edhe nëse do të jetë e nevojshme të bëjnë të ditur të dhënat e tyre personale. Për më tepër, rreth gjysma e atyre që nuk janë të gatshëm të denoncojnë rastet e korrupsionit, sepse u duhet të zbulojnë të dhënat e tyre personale (49%), do të ndryshonin mendje dhe do të raportonin rastet e korrupsionit, nëse do ta bënin këtë raportin në mënyrë anonime. Kjo është një gjetje inkurajuese, që duhet të përdoret me doemos në luftën kundër korrupsionit në polici. Nëse qytetarët tashmë janë të gatshëm të denoncojnë rastet e korrupsionit, atëherë duhet të bëhen më shumë përpjekje për rritjen e besimit të tyre tek mekanizmat institucionalë anti-korrupsion. Nëse qytetarët kanë besim se rasti i raportuar i korrupsionit do të zgjidhet nga institucionet, atëherë ata do të bëhen aleatë të rëndësishëm për identifikimin dhe denoncimin e zyrtarëve të korruptuar të policisë.


### Grafiku 27: Denoncimi i korrupsionit të policisë në Maqedoni

Pyetja: A do ta denonconit një rast korrupsioni në polici (nëse ju kërkon dikush ryshfet) nëse ju duhet që të jepni të dhënat tuaja personale (numrin personal, adresën, etj.)?



### Grafiku 28: Denoncimi i korrupsionit të policisë në mënyrë anonime në Maqedoni

Pyetja: A do ta denonconit një rast korrupsioni në polici (nëse ju kërkon dikush ryshfet) nëse nuk do t'ju duhej që të jepni të dhënat tuaja personale (numrin personal, adresën, etj.)?




Megjithatë, ekzistojnë dallime të mëdha nëse bëjmë krahasime sipas etnisë kur vjen fjala për gatishmërinë për të raportuar korrupsionin e policisë. Ndërkohë që 76% e maqedonasve etnikë thanë se ata do të denonconin me të vërtetë rastet e korrupsionit, e njëjta përgjigje u dha nga vetëm 58% e shqiptarëve etnikë që iu përgjigjën kësaj pyetjeje. Kjo përqindje është e lartë; gjithsesi, ajo mbetet nën mesataren kombëtare. Përveç kësaj, ka një rënie në gatishmërinë e shqiptarëve për të raportuar korrupsionin në polici në krahasim me vitin e kaluar (2016), kur 69% e tyre ishin të gatshëm të denonconin rastet e korrupsionit të policisë.

Po ashtu, ka disa dallime të vogla mes gjinive në lidhje me këtë pyetje; femrat janë më të gatshme të raportojnë rastet e korrupsionit në polici (rastet ku u kërkohet ryshfet) në krahasim me meshkujt.


### Grafiku 29: Dallimet sipas etnisë në perceptimin për denoncimin e korrupsionit të policisë

Pyetja: A do ta denonconit një rast korrupsioni në polici (nëse ju kërkon dikush ryshfet) nëse ju duhet që të jepni të dhënat tuaja personale (numrin personal, adresën, etj.)?



### Grafiku 30: Dallimet sipas gjinisë në perceptimin për denoncimin e korrupsionit të policisë

Pyetja: A do ta denonconit një rast korrupsioni në polici (nëse ju kërkon dikush ryshfet) nëse ju duhet që të jepni të dhënat tuaja personale (numrin personal, adresën, etj.)?



## Stacioni lokal i policisë është zgjedhja e parë për denoncimin e korrupsionit të policisë

Stacioni i policisë lokale është adresa e parë e zgjedhur nga një e treta e qytetarëve që janë të gatshëm të denoncojnë rastet e korrupsionit në polici. Të tjerët janë të ndarë mes: Agjencisë Kundër Korrupsionit (15%), shefi i stacionit të policisë (15%), shërbimi i kontrollit të brendshëm të policisë (13%) dhe një mik që punon në polici (12%). Disa nga qytetarët do të shkonin më parë tek media (7%), ndërsa disa të tjerë do të raportnin një rast korrupsioni tek OJQ-të (3%). Përveç zgjedhjes së tyre të parë, pjesëmarrësit në sondazh u pyetën edhe për emrin e institucioneve të tjera tek të cilat ata do të raportnin një rast korrupsioni të policisë. Stacionet e policisë ishin përsëri zgjedhja më popullore, duke qenë se këto stacione u zgjodhën nga gjysma (50%) e të intervistuarve. Më pas vinin shefi i stacionit të policisë (37%), gjë që sugjeron se qytetarët do t'i drejtoheshin stacionit të policisë që në fillim, por do të kërkonin në mënyrë specifike të bisedonin fillimisht me drejtuesin e stacionit të policisë për të raportuar rastin e korrupsionit. Për këtë arsye, Ministria e Brendshme duhet të hartojë udhëzime të qarta për stacionet e policisë dhe të organizojë trajnime për stafin e këtyre stacioneve për mënyrën e trajtimit të situatave të tilla.

Njësia e kontrollit të brendshëm, e cila në fakt është përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit në polici, nuk është një zgjedhje shumë e pëlqyeshme nga të intervistuarit. Vetëm një e katërta (26%) e qytetarëve do të zgjidhnin këtë njësi për të raportuar një rast korrupsioni në polici. Po ashtu, përqindja e të anketuarve që e ka përmendur këtë njësi është edhe më e vogël se ajo e vitit të kaluar (në vitin 2016 kjo përqindje ishte 32%). Kjo do të thotë se duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të promovuar punën e njësive së kontrollit të brendshëm, por edhe për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin e saj në mënyrë që të fitojë besimin e qytetarëve. Nga ana tjetër, është interesante të theksohet se një e katërta e të intervistuarve do të raportnin një rast korrupsioni tek një shok/shoqe që punon në polici. Kjo tregon se qytetarët ndonjëherë preferojnë më shumë kanalet informale dhe se pëlqejnë më shumë t'i drejtohen njerëzve si individë sesa institucioneve. Për këtë arsye, Ministria e Brendshme duhet të sigurohet që punonjësit e saj të jenë të vetëdijshëm për mekanizmat institucionalë për luftën kundër korrupsionit në polici dhe që ata të veprojnë si promovues të këtyre mekanizmave në komunitetin e tyre.


### Grafiku 31: Alternativat për denoncimin e korrupsionit të policisë (përgjigja e parë)

Pyetja: Cilit nga lista e mëposhtme do t'i raportoni të parit rastin e korrupsionit në polici? Kujt tjetër?



### Grafiku 32: Alternativat për denoncimin e korrupsionit të policisë (shumë përgjigje)

Pyetja: Cilit nga lista e mëposhtme do t'i raportoni të parit rastin e korrupsionit në polici? Kujt tjetër?



## Motivimi i qytetarëve për të raportuar korrupsionin e policisë është masa më e domosdoshme

Njerëzit besojnë se motivimi dhe inkurajimi i qytetarëve për të raportuar korrupsionin e policisë është masa më e domosdoshme për parandalimin e korrupsionit në këtë institucion. E njëjta përgjigje është dhënë nga 25% e të anketuarve. Rritja e pagave të punonjësve të policisë si masa më e rëndësishme u vjen në mendje si mendim i parë 14% të të anketuarve, ndërsa 13% e të intervistuarve kërkojnë më shumë ndëshkime për zyrtarët e korruptuar në radhët e policisë. Një zgjidhje tjetër, sipas 10% të të intervistuarve, qëndron në krijimin e një agjencie të re për parandalimin e korrupsionit në polici, ndërsa të tjerët janë të ndarë mes zbatimit të ndëshkimeve të rrepta ndaj shkelësve (9%), vullnetit politik të Ministrit dhe drejtuesve të policisë për të zgjidhur problemin (8%), forcimit të kompetencave të kontrollit të brendshëm të policisë, inkurajimit të punonjësve të policisë për të denoncuar rastet e korrupsionit (6%) dhe zgjidhjeve të tjera.

Vihen re disa dallime në perceptimet e të anketuarve sipas përkatësisë së tyre etnike. Përveç faktit se motivimi i qytetarëve për të raportuar korrupsionin policor është zgjedhja më e pranishme tek maqedonasit etnikë (25%), këta të fundit priren të kërkojnë më shumë ndëshkime për zyrtarët e korruptuar të policisë (15% e maqedonasve etnikë në krahasim me 7% të shqiptarëve) dhe ndëshkime më të ashpra ndaj shkelësve (11% të maqedonasve përkundrejt 8% të shqiptarëve). Nga ana tjetër, shqiptarët etnikë kanë zgjedhur rritjen e pagave të policëve (25% e shqiptarëve etnikë në krahasim me 9% të maqedonasve etnikë), por edhe krijimin e një agjencie të re për parandalimin e korrupsionit në polici (18% e shqiptarëve etnikë krahasuar me 7% të maqedonasve etnikë). Me fjalë të tjera, maqedonasit etnikë kanë tendencë të kërkojnë më shumë ndëshkime të rrepta kundër fenomenit të korrupsionit në polici, ndërkohë që shqiptarët etnikë zgjedhin masat parandaluese.


### Grafiku 33: Masat më të domosdoshme për parandalimin e korrupsionit në polici

Pyetja: Sipas mendimit, çfarë është më e domosdoshme për parandalimin e korrupsionit në radhët e policisë?



### Grafiku 34: Dallimet sipas etnisë për masat më të domosdoshme për parandalimin e korrupsionit në polici

Pyetja: Sipas mendimit, çfarë është më e domosdoshme për parandalimin e korrupsionit në radhët e policisë?



Të anketuarve iu kërkua të shihnin një listë të institucioneve dhe të përgjigjeshin se cili prej tyre duhet të ishte përgjegjës për parandalimin e korrupsionit në polici. Pjesa më e madhe e qytetarëve e perceptojnë korrupsionin e policisë si një çështje që duhet të trajtohet brenda vetë policisë. Pothuajse një e katërta e të anketuarve mendojnë se kryesisht ky është roli që duhet të luhet nga shërbimi i kontrollit të


brendshëm në polici, ndërsa 12% besojnë se Ministri i Brendshëm duhet të jetë i pari në parandalimin e korrupsionit në polici. Po ashtu, 9% e popullsisë mendon se policët vetë duhet të jenë vetë të parët për të luftuar korrupsionin në polici.

Megjithatë, Qeveria dhe Parlamenti kanë marrë rezultate relativisht të larta (12% sugjeruan Qeverinë dhe 9% Parlamentin si institucionet më të rëndësishme). Rezultate të larta mori edhe Agjencia Kundër Korrupsionit (11%).

Në përgjigjet e tjera përfshihen: prokuroria (6%), komuniteti ndërkombëtar (4%), sindikata e policisë (4%), OJQ-të (2%) apo të tjera. Drejtori i Policisë doli si instanca e fundit në mendjet e qytetarëve si aktor i rëndësishëm për parandalimin e korrupsionit në polici. Drejtori i Policisë konsiderohet më i rëndësishëm nga vetëm 2% e popullsisë.

### Grafiku 35: Institucionet që duhet të drejtojnë luftën kundër korrupsionit

Pyetja: Shikoni listën e mëposhtme të institucioneve dhe thoni se cili nga institucionet para të gjitha të tjerave duhet të luftojë korrupsionin në polici.




### OJQ-të duhet të bashkëpunojnë me shtetin në luftën kundër korrupsionit

Qytetarët e Maqedonisë presin që OJQ-të luajnë rolin e partnerit të shtetit në luftën kundër korrupsionit. Kështu, 42% e të intervistuarve thanë se roli i OJQ-ve në luftën kundër korrupsionit duhet të jetë bashkëpunimi me shtetin në përpjekjet për të luftuar fenomenin. Një e pesta e qytetarëve duan që OJQ-të të marrin pjesë aktive në luftën kundër korrupsionit, ndërsa 12% mendojnë se OJQ-të duhet të bëjnë hulumtime dhe të japin rekomandime për luftën kundër korrupsionit. Dhënia e ndihmës për viktimat e korrupsionit shihej nga 9% e të anketuarve si roli i duhur për OJQ-të, ndërsa 7% thanë se OJQ-të duhet të promovojnë punën e ndershme dhe etike tek institucionet publike.

### Grafiku 36: Roli i OJQ-ve në luftën kundër korrupsionit


Pyetja: Njerëzit kanë mendime të ndryshme për rolin e organizatave joqeveritare në luftën kundër korrupsionit. Duke marrë këtë parasysh, cili mendoni se do ishte roli që duhet të luajnë OJQ-të në luftën kundër korrupsionit?



Nuk janë vënë re dallime të mëdha mes grupeve etnike në aspektin e pikëpamjeve të tyre për rolin e OJQ-ve në luftën kundër korrupsionit. Plot 43% e shqiptarëve dhe 41% e maqedonasve etnikë besojnë se OJQ-të duhet të luftojë korrupsionin në bashkëpunim me shtetin. Megjithatë, përqindja e shqiptarëve që besojnë se OJQ-të duhet të marrë një rol aktiv në luftën kundër korrupsionit është më e lartë se përqindja e maqedonasve etnikë me të njëjtin mendim (26% e shqiptarëve në krahasim me 41% të maqedonasve etnikë).

### Grafiku 37: Dallimet sipas etnisë për rolin e OJQ-ve në luftën kundër korrupsionit

Pyetja: Njerëzit kanë mendime të ndryshme për rolin e organizatave joqeveritare në luftën kundër korrupsionit. Duke marrë këtë parasysh, cili mendoni se do ishte roli që duhet të luajnë OJQ-të në luftën kundër korrupsionit?





# KUADRI METODOLOGJIK

|   |  |
|---|--|
| <b>Vendi</b>                            | Maqedoni   |
| <b>Koha</b>                             | Korrik 2017  |
| <b>Metoda e mbledhjes së të dhënave</b> | Intervistë telefonike e asistuar me kompjuter (CATI)   |
| <b>Kampionimi</b>                       | Qytetarë dhe qytetare të Maqedonisë të moshës mbi 18 vjeç, të cilët janë me banim të përhershëm në territorin e Maqedonisë në kohën e kryerjes së këtij sondazhi |
| <b>Madhësia e kampionit</b>             | 1,000  |
| <b>Lloji i kampionit</b>                | Kampion me shtresëzim përfaqësimi rastësor me tre faza   |
| <b>Shtresëzimi</b>                      | Kryer sipas rajoneve, llojit të vendbanimit, gjinisë, moshës dhe nivelit të arsimit  |
| <b>Marzhi i gabimit</b>                 | ±3.31%   |

# POINTPULSE

WESTERNBALKANS PULSE FOR POLICE INTEGRITY AND TRUST

[WWW.POINTPULSE.NET](http://WWW.POINTPULSE.NET)



[twitter.com/POINTPULSEnet](https://twitter.com/POINTPULSEnet)



[facebook.com/POINTPULSEnet/](https://facebook.com/POINTPULSEnet/)

Civil society network dedicated to oversight of police integrity.